

(3) Надоместокот од ставот (2) на овој член не може да биде повисок од 35% од износот на основната плата и истиот се исплаќа за определен временски период.

(4) Критериумите за исплата на надоместокот од ставот (2) на овој член со акт поблиску ги уредува директорот.

(5) Вработените кои вршат помошни или технички работи немаат статус на административни службеници и во однос на нивните права, обврски и одговорности се применува членот 3 од Законот за вработените во јавниот сектор.

VII. ФИНАНСИРАЊЕ И СРЕДСТВА ЗА РАБОТА НА АКАДЕМИЈАТА

Извори на финансирање

Член 66

(1) Средствата за работа на Академијата се обезбедуваат од Буџетот на Република Северна Македонија преку буџетот на „Судската власт“.

(2) Други извори на финансирање се:

- самостојни приходи,
- приходи преку издавање на публикации,
- приходи од реализација на обуки за правосудството и за други цели групи кои се надвор од областа на правосудството,
- реализација на проекти,
- грантови и донации, кои не се во спротивност со дејноста на Академијата.

(3) За изворите наведени во ставот (2) на овој член, директорот на Академијата го информира Управниот одбор.

(4) Буџетските средства од ставот (1) на овој член се обезбедуваат во висина за да го покријат организирањето и спроведувањето на испитите, програмите за обука, како и други трошоци кои произлегуваат од тековното работење на Академијата согласно со овој закон.

Надзор

Член 67

Надзор над спроведувањето на одредбите на овој закон врши Министерството за правда.

VIII. ПРЕКРШОЧНИ ОДРЕДБИ

Член 68

Глоба во износ од 10.000 евра во денарска противвредност ќе му се изрече за прекршок на овластено правно лице кое технички го спроведува испитот доколку не го блокира радиорефлекенцискиот опсег во просторијата за полагање на испитот (член 41 став (1) од овој закон).

Член 69

Глоба во износ од 1.000 евра во денарска противвредност ќе му се изрече за прекршок на член на Комисијата за ревизија ако утврди неправилности во спроведувањето на испитите, а тоа не го констатира во извештајот до Управниот одбор на Академијата.

Член 70

За прекршоците утврдени со овој закон прекршочна постапка води и прекршочна санкција изрекува надлежен суд.

IX. ПРЕОДНИ И ЗАВРШНИ ОДРЕДБИ

Член 71

(1) Директорот, заменикот директор, членовите на Управниот одбор и на Програмскиот совет на Академијата именувани согласно со Законот за Академијата за судии и јавни обвинители („Службен весник на Република Македонија“ број 20/15, 192/15, 231/15 и 163/18), ќе ја извршуваат должноста до завршување на мандатот за кој се избрани.

(2) Комисијата за приемен испит, Комисијата за завршен испит и Комисијата за ревизија на одржаните испити, ќе ја извршуваат должноста до завршување на мандатот за кој се избрани.

(3) Директорот, заменикот директор и членовите на органите од ставот (1) на овој член кои се избрани првпат согласно со Законот за Академијата за судии и јавни обвинители („Службен весник на Република Македонија“ број 20/15, 192/15, 231/15 и 163/18) имаат право на уште еден избор според овој закон.

(4) Директорот, членовите на Управниот одбор, Програмскиот совет и на комисиите за приемен испит за ревизија на одржаните испити и за завршен испит на Академијата именувани во два мандат до денот на влегувањето во сила на овој закон според прописите кои важеле до денот влегувањето во сила на овој закон, немаат право на уште еден мандат според овој закон.

Член 72

(1) Сите започнати постапки за прием на слушатели на почетна обука во Академијата за судии и јавни обвинители ќе се спроведат и ќе се завршат согласно со одредбите од овој закон.

(2) Генерацијата кандидати за судии и јавни обвинители која во моментот на влегувањето во сила на овој закон е во тек со обуката, истата ќе ја завршат согласно со одредбите од овој закон.

Член 73

Подзаконските акти предвидени со овој закон Управниот одбор ќе ги донесе во рок од еден месец од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Член 74

Со денот на влегувањето во сила на овој закон престанува да важи Законот за Академијата за судии и јавни обвинители („Службен весник на Република Македонија“ број 20/15, 192/15, 231/15 и 163/18).

Член 75

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Северна Македонија“.

L I G J I

I AKADEMISË SË GJYKATËSVE DHE TË PROKURORËVE PUBLIKË

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Lënda e ligjit

Neni 1

Me këtë ligj rregullohet puna e Akademisë së Gjykatësve dhe të Prokurorëve Publikë (në tekstin e mëtejshëm: Akademia) statusi i saj, veprimtaria, organet e administrimit, financimi, trajnimi fillestar dhe i vazhdueshëm.

Qëllimi dhe veprimtaria e Akademisë**Neni 2**

(1) Qëllimi i Akademisë është që të sigurojë kryerje profesionale, të pavarur, të paanshme dhe efikase të funksionit të gjykatësit dhe prokurorit publik, si dhe kryerje profesionale dhe efikase të punëve të shërbimeve profesionale në gjyqësi dhe prokurorinë publike.

(2) Akademia bën pranimin dhe përsosjen profesionale të kandidatëve për gjykatës dhe prokurorë pu blikë, trajnim të vazhdueshëm për avancim të profesion alizimit të gjykatësve dhe prokurorëve publikë, trajnim të vazhdueshëm të shërbimeve profesionale në gjyqësi dhe në prokurori publike, trajnim të specializuar për gjykatësit e jurisë, trajnim të subjekteve të cilat marrin pjesë në zbatimin e ligjit nga sfera e gjyqësorit, si dhe për shkak të kryerjes së veprimtarisë hulumtuese-analitike nga sfera e teorisë dhe praktikës gjyqësore.

(3) Akademia veprimtarinë e vet e zbaton nëpërmjet:

- organizimit dhe zbatimit të trajnimit fillestar të kandidatëve të ardhshëm për gjykatës dhe prokurorë publikë në gjykatat themelore dhe në prokuroritë themelore publike,

- organizimit dhe zbatimit të trajnimit të vazhdueshëm për përparimin e profesionalizimit të gjykatësve dhe të prokurorëve publikë,

- organizimit dhe zbatimit të trajnimit të vazhdueshëm të shërbimeve profesionale në gjyqësi dhe në prokurorinë publike, si dhe trajnimit të subjekteve të tjera të cilët marrin pjesë në zbatimin e ligjit në sferat e gjyqësorit,

- zbatimit të veprimtarisë analitike-hulumtuese nga sfera e teorisë dhe praktikës gjyqësore dhe

- kryerjes së punëve të tjera të përcaktuara me ligj dhe Statutin e Akademisë (në tekstin e mëtuajshëm: Statuti).

(4) Për zbatim të veprimtarisë, Akademia:

- vendos dhe bashkëpunon në fushën e trajnimit me institucione të ngjashme vendase dhe institucione të huaja, organizata, shoqata dhe fondacione, në veçanti me shoqatat profesionale të gjykatësve dhe të prokurorëve publikë dhe odave,

- bashkëpunon me rrjetet europiane të institucioneve për trajnim, si dhe Rrjetin e Lisbonës pranë Këshillit të Europës dhe Rrjetit European për Trajnim në Bashkimit European,

- realizon këmbim ndërkombëtar të gjykatësve, prokurorëve publikë, si dhe të subjekteve të theksuara në nenin 2 të këtij ligji,

- organizon dhe mban bibliotekë,

- boton publikime dhe kryen veprimtari tjetër botuese për nevojat e veta,

- realizon bashkëpunim me fakultetet juridike për shkak të zhvillimit të programeve për orientim profesional dhe përgatitjen e studentëve nga fakultetet juridike për pranim në Akademi,

- organizon dhe merr pjesë në projektet hulumtuese dhe

- kryen edhe veprimtari të tjera në rëndësi për avancim dhe përsosje të trajnimeve të gjyqësorit, të përcaktuara me këtë ligj dhe Statut.

Selia e Akademisë**Neni 3**

(1) Akademia themelohet si institucion publik me cilësi të personit juridik.

(2) Selia e Akademisë është në Shkup.

Vula e Akademisë**Neni 4**

(1) Akademia ka vulë, e cila përmban emrin Republika e Maqedonisë së Veriut, stemën e Republikës, emërtimin dhe selinë e Akademisë dhe është e shkruar në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% të qytetarëve dhe alfabetin e saj.

(2) Forma dhe përmbajtja e vulës, pamja e shenjave dhe shënimeve tjera dhe mënyra e shfrytëzimit rregullohet me Statut, në pajtim me ligjin.

Aktet e Akademisë**Neni 5**

(1) Akt themelor i Akademisë është Statuti.

(2) Me Statutin në mënyrë më të afërt rregullohen:

- emërtimi, organizimi i brendshëm dhe mënyra e kryerjes së veprimtarisë së Akademisë,

- menaxhimi dhe udhëheqja me Akademinë,

- të drejtat dhe obligimet e subjekteve sipas nenit 2 të këtij ligji në lidhje me punën e Akademisë,

- përbërja, mënyra e formimit, si dhe mënyra e vendimmarrjes dhe fushëveprimi i punës së organeve dhe trupave të Akademisë,

- të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e Akademisë në qarkullimin juridik,

- pranimi i dëgjuesve në trajnimin fillestar,

- procedura e miratimit të programeve për të gjitha llojet e trajnimeve,

- mënyra e zgjedhjes së ligjëruesve dhe mentorëve,

- mënyra e financimit dhe përdorimi i mjeteve për punë në Akademi dhe

- çështje tjera me rëndësi për punën e Akademisë.

(3) Statutin e miraton Këshilli drejtues i Akademisë me shumicën e dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

(4) Statuti botohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në ueb faqen e Akademisë.

(5) Aktet tjera të përgjithshme dhe raportet e Akademisë publikohen në ueb faqen e saj.

Ndalesa për organizim politik në Akademi**Neni 6**

Në Akademi nuk lejohet organizim dhe veprim politik dhe partiak.

Përfaqësimi i drejtë**Neni 7**

(1) Gjatë përzgjedhjes së kandidatëve për pranim në trajnimin fillestar në Akademi, pa shkelur kriteret e përcaktuara me këtë ligj, sigurohet përfaqësim i duhur dhe i drejtë i qytetarëve që i përkasin të gjitha bashkësive në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(2) Përfaqësimi i duhur dhe i drejtë sigurohet me përcaktimin paraprak të kuotës së posaçme për përfaqësuesit e bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke llogaritur nga numri i përgjithshëm i vendeve të lira për gjykatës dhe prokurorë publik i përcaktuar në shpalljen publike për pranim në trajnimin fillestar, e i cili numër përcaktohet nga ana e Këshillit drejtues për çdo regjistrim në mënyrë të posaçme.

(3) Këshilli drejtues e përcakton kuotën e paragrafit (2) të këtij neni, sipas treguesit statistikor zyrtar nga e gjithë popullsia e regjistruar nga regjistrimi i fundit i realizuar në vend.

на Република Северна Македонија

(4) Mënyra e plotësimit të vendeve të lira të përcaktuara sipas kuotës, gjatë pranimit të kandidatëve në trajnimin fillestar do të bëhet sipas parimit të suksesit të arritur sipas notës përfundimtare të fituar nga provimi i dhënë pranues, e i cili plotësim do të renditet në kuadër të çdo kuote të parashikuar në veçanti.

(5) Përderisa në kuotat e parashikuara sipas paragrafit (3) të këtij neni nuk paraqitet numër i mjaftueshëm i kandidatëve të cilët i plotësojnë kushtet ligjore ose të cilët nuk e kanë dhënë provimin pranues, vendet e lira plotësohen nga kandidatët e tjerë të cilët i plotësojnë kushtet sipas rangimit të notës së tyre përfundimtare.

II. MENAXHIMI I AKADEMISË

Organet e Akademisë

Neni 8

(1) Organet e Akademisë janë Këshilli drejtues, drejtori dhe Këshilli i programit.

(2) Gjatë konstituimit të organeve dhe trupave të Akademisë, caktimit të përkthyesve dhe mentorëve, konstituimi i Komisionit të provimit pranues, Komisionit të provimit përfundimtar dhe i Komisionit të revizionit të provimeve të mbajtura, sigurohet përfaqësim i drejtë dhe adekuat i qytetarëve që u takojnë të gjitha bashkësive në Republikën e Maqedonisë së Veriut, pa u prishur kriteret e përcaktuara me këtë ligj.

1. Këshilli drejtues

Përbërja e Këshillit drejtues

Neni 9

(1) Këshilli drejtues është organ drejtues i Akademisë dhe përbëhet nga nëntë anëtarë.

(2) Katër anëtarë dhe zëvendësit e tyre në Këshillin drejtues emërohen nga radhët e gjykatësve, edhe atë: dy anëtarë dhe zëvendësit e tyre janë gjykatës të emëruar nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtutjeshëm: Këshilli Gjyqësor), një anëtar dhe zëvendësi i tij janë gjykatës të emëruar në seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtutjeshëm: Gjykata Supreme) dhe një anëtar dhe zëvendësi i tij janë gjykatës të emëruar nga Këshilli drejtues i Shoqatës së Gjykatësve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(3) Katër anëtarë dhe zëvendësit e tyre në Këshillin drejtues emërohen nga radhët e prokurorëve publikë, edhe atë: dy anëtarë dhe zëvendësit e tyre janë prokurorë publikë të emëruar nga Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtutjeshëm: Këshilli i Prokurorëve Publikë), një anëtar dhe zëvendësi i tij janë prokurorë publik të emëruar nga Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe një anëtar dhe zëvendësi i tij janë prokurorë publikë të emëruar nga Këshilli Ekzekutiv i Shoqatës së Prokurorëve Publikë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(4) Për anëtar ose zëvendësanëtar në Këshillit drejtues nga radhët e gjykatësve dhe të prokurorëve mund të emërohen gjykatësit dhe prokurorët publikë së paku me tetë vjet përvojë pune si gjykatës, përkatësisht prokuror publik, me rezultate pozitive në punën e tyre.

(5) Ministri i Drejtësisë emëron një anëtar dhe zëvendësin e tij në Këshillin drejtues nga nëpunësit administrativë udhëheqës në Ministrinë e Drejtësisë me të paktën tetë vjet përvojë pune në një pozitë udhëheqëse dhe me rezultate pozitive në punë.

(6) Drejtori merr pjesë në punën e Këshillit drejtues, dhe në mungesë të tij zëvendësdrejtori i Akademisë, pa të drejtë vote.

(7) Një muaj para skadimit të mandatit të anëtarëve të Këshillit drejtues dhe zëvendësve të tyre, emërohen anëtarë të Këshillit drejtues dhe zëvendësit e tyre, në pajtim me kushtet e përcaktuara me këtë ligj.

(8) Seanca konstituive e Këshillit drejtues mbahet më së voni në afat prej 15 ditësh pas përfundimit të mandatit të Këshillit drejtues të mëparshëm, ndërsa e thërret dhe me të kryeson anëtarin më i vjetër i emëruar i Këshillit drejtues.

(9) Mandati i anëtarëve të Këshillit drejtues dhe zëvendësve të tyre zgjat katër vjet pa të drejtë të rizgjedhjes.

Kryetari i Këshillit drejtues

Neni 10

(1) Kryetari i Këshillit drejtues dhe zëvendësi i tij zgjidhen nga radha e gjykatësve dhe e prokurorëve publikë, anëtarë të Këshillit drejtues.

(2) Mandati i kryetarit dhe zëvendëskryetarit në Këshillin drejtues zgjat dy vjet, me mundësi për zgjedhje edhe të njëhershme.

Kompetenca e Këshillit drejtues

Neni 11

Këshilli drejtues kryen veprimtaritë e mëposhtme:

- miraton Statutin dhe aktet e tjera të përgjithshme të Akademisë dhe monitoron realizimin e tyre,

- miraton Rregulloren për punën e saj,

- zgjedh kryetarin e Këshillit drejtues dhe zëvendësin e tij,

- emëron, përcakton ndërprerjen e mandatit dhe shkarkon drejtorin dhe zëvendësdrejtorin (në tekstin e mëtutjeshëm: zëvendësi),

- vendos mbi largimin e përkohshëm nga puna të drejtorit dhe zëvendësdrejtorit gjatë procedurës së iniciuar për shkarkim,

- konstaton dhe përcakton ndërprerjen dhe shkarkimin e një anëtarit dhe zëvendësanëtarit të Këshillit drejtues,

- emëron dhe përcakton ndërprerjen dhe shkarkimin e një anëtarit dhe zëvendësanëtarit të Këshillit të programit,

- realizon thirrje publike për zgjedhjen e dy anëtarëve dhe zëvendësve të tyre në Këshillin e programit,

- përcakton listën e ligjëruesve dhe vendos për shkarkimin e tyre me propozim të drejtorit,

- përcakton fillimin e zbatimit të provimit pranues për trajnimin fillestar,

- formon dhe shkarkon komisionet në pajtim me këtë ligj, përcakton ndërprerjen e mandatit të anëtarëve të komisioneve,

- shqyrton dhe miraton raportet e dorëzuara për punën e tyre,

- përcakton listën e mentorëve dhe përcakton ndërprerjen e statusit të mentorit,

- përcakton programet e trajnimit,

- miraton akte për çështjet për të cilat në këtë ligj përcaktohet autorizimi që t'i miratojë Akademia,

- miraton Planin vjetor financiar,

- miraton Planin vjetor të furnizimeve publike,

- përcakton mënyrën e përdorimit të mjeteve për punën e Akademisë,

- miraton planin strategjik të Akademisë,

- miraton llogarinë përfundimtare dhe Programin e punës së Akademisë

- miraton Raportin vjetor të punës së Akademisë të vitit të kaluar,

- jep mendim për bashkëpunimin me institucionet përkatëse, organizatat dhe shoqatat nga vendi dhe jashtë vendit, për projekte, grante dhe donacione ndërkombëtare,

- njihet me aktet për organizim dhe sistematizim të brendshëm të vendeve të punës të miratuara me pëlqim paraprak të Ministrisë e Shoqërisë Informatike dhe të Administratës nga ana e drejtorit,

- miraton akte të tjera të përgjithshme me propozim të drejtorit,

- miraton vendime për angazhime këshilluese të ekspertëve nga fusha të ndryshme,

- miraton vendime, aktvendime dhe konkluzione dhe

- kryen veprimtari të tjera të përcaktuara me këtë Ligi dhe Statut.

Mënyra e punës së Këshillit drejtues

Neni 12

(1) Punët nga fushëveprimi i tij Këshilli drejtues i kryen në një seancë publike nëse është e pranishme shumica e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit drejtues.

(2) Këshilli drejtues miraton vendime me shumicën e votave të anëtarëve të Këshillit drejtues, përveç në rastet e parashikuara me këtë ligj.

(3) Nëse shumica e kërkuar sipas paragrafit (2) të këtij neni nuk sigurohet, seanca shtyhet dhe kryetari menjëherë cakton një seancë të re e cila do të mbahet jo më vonë se tetë ditë nga dita e shtyrjes së seancës.

(4) Seancat e Këshillit drejtues thirren dhe me atë kryeson kryetari i Këshillit drejtues.

(5) Seancë e Këshillit drejtues mund të thirret edhe me kërkesë të drejtorit ose të një anëtari të Këshillit drejtues.

(6) Konsiderohet se një anëtar i Këshillit drejtues është i pranishëm nëse ekziston një lidhje telefonike ose lidhje tjetër dykahëshe e njoftuar më parë (video konferencë), e cila garanton identifikimin e pjesëmarrësit dhe lejon pjesëmarrjen në diskutim dhe në miratimin e vendimeve të cilën detyrimisht e evidenton në procesverbal.

(7) Këshilli drejtues mund të vendosë të mbajë seancat edhe nëpërmjet telefonit ose lidhjes tjetër të video konferencës nëse garantohet identifikimi i pjesëmarrësve dhe lejon pjesëmarrjen në diskutim dhe në miratimin e vendimeve, të cilën detyrimisht e evidenton në procesverbal.

(8) Në rast se një anëtar i Këshillit drejtues pengohet të marrë pjesë në një seancë të caktuar të Këshillit drejtues, është i detyruar të informojë me kohë Akademinë, dhe në seancë thirret zëvendësi i tij për pjesëmarrje të cilit i dorëzohet rendi i ditës dhe materialet për seancën.

(9) Për çdo seancë mbahet procesverbal, të cilin e nënshkruan kryesuesi i seancës dhe procesverbalisti. Kryetari i Këshillit drejtues mund të vendosë që seanca të incizohet edhe në mënyrë audiovizuale.

(10) Procesverbali sipas paragrafit (9) të këtij neni mbahen nga personi i punësuar në Shërbimin për punë tekniko-profesionale të Akademisë i cili kryhen edhe punët tjera administrative dhe profesionale për nevoja të Këshillit drejtues, të përcaktuara me aktin e sistematizimit të vendeve të punës ose me vendim të drejtorit.

Kompensimi i shpenzimeve të anëtarëve të Këshillit drejtues

Neni 13

(1) Anëtarët e Këshillit drejtues kanë të drejtë për një kompensim në të holla mujore që është 50% e pagës mesatare mujore të paguar në Republikë në tre muajt e fundit.

(2) Anëtarët e Këshillit drejtues, të cilët kanë një vendbanim ose qëndrojnë jashtë selisë së Akademisë, kanë të drejtën e kompensimit të shpenzimeve rrugore, në pajtim me aktet e Akademisë.

(3) Kompensimi mujor i parashikuar për punën e anëtarit të Këshillit drejtues i paguhet anëtarit dhe zëvendësanëtarit në proporcion me numrin e seancave që mori pjesë në muajin aktual për të cilin bëhet pagesa.

Ndërprerja e mandatit dhe shkarkimi i një anëtari të Këshillit drejtues

Neni 14

(1) Mandati i anëtarit dhe zëvendësanëtarit të Këshillit drejtues ndërpritet:

- me skadimin e kohës për të cilën janë emëruar,

- me kërkesë të tij,

- për shkak të vdekjes,

- nëse i ndërpritet funksioni ose marrëdhënia e punës në organin ku e kryen funksionin, përkatësisht ku ka themeluar marrëdhënie pune dhe

- nëse pengohet të kryejë funksionin e anëtarit ose zëvendësanëtarit të Këshillit drejtues për më shumë se gjashtë muaj për shkak të sëmundjes ose arsyeve të tjera.

(2) Anëtari dhe zëvendësanëtari i Këshillit drejtues shkarkohen nëse:

- me aktgjykim të plotfuqishëm i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës për veprë penale ose kundërvajtje të ndërlydhura me keqpërdorimin e funksionit të gjykatësit ose prokurorisë publike ose pozicionit të punës në Ministrinë e Drejtësisë,

- me vendim gjyqësor të plotfuqishëm është dënuar për veprë penale me dënim me burg në kohëzgjatje mbi gjashtë muaj dhe

- vepron në kundërshtim me rregulloret në fushën e parandalimit të korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

(3) Në rastet sipas paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni, organi që emëroi anëtarin, përkatësisht zëvendësanëtarin i cili u shkarkua ose mandati i të cilit u ndërpre, do të emërojë një anëtar të ri, përkatësisht zëvendësanëtar jo më vonë se 30 ditë nga dita e miratimit të vendimit për shkarkim, përkatësisht ndërprerjen e mandatit.

(4) Mandati i anëtarit të sapoemëruar, përkatësisht zëvendësanëtarit të Këshillit drejtues zgjat deri në skadimin e mandatit të anëtarit në vendin e të cilit është emëruar.

(5) Deri në emërimin e një anëtari të ri të Këshillit drejtues, funksionin e anëtarit e kryen zëvendësanëtari, dhe deri në zgjedhjen e kryetarit të ri të Këshillit drejtues, funksionin e kryetarit e kryen zëvendëskryetari i Këshillit drejtues.

2. Drejtori dhe zëvendësi

Drejtori dhe zëvendësi i drejtorit

Neni 15

(1) Drejtori është organi drejtues dhe ekzekutiv i Akademisë dhe i njëjti ka zëvendës.

(2) Drejtori dhe zëvendësi emërohen për një periudhë katër vjeçare, me të drejtë të zgjedhjes së njëhershme.

(3) Zëvendësi e zëvendëson drejtorin në rast kur ai mungon, ose kur për shkak të sëmundjes dhe arsyeve të tjera nuk është në gjendje të kryejë funksionin e tij.

(4) Zëvendësi kryen detyra brenda kompetencës së drejtorit që do t'i besojë ai, dhe ato i përkasin fushëveprimitt të detyrave të punës së tij.

(5) Drejtori dhe zëvendësi emërohen nga Këshilli drejtues në bazë të një konkursit publik të botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në ueb faqen e Akademisë dhe në të paktën në dy gazeta ditore, prej të cilave njëra e çila botohet në gjuhën maqedonase dhe njëra nga gazetata që flasin të paktën 20% e qytetarëve që flasin një gjuhë zyrtare tjetër të ndryshme nga gjuha maqedonase.

(6) Këshilli drejtues është i detyruar vendimin për shpalljen e konkursit publik për zgjedhjen e drejtorit dhe zëvendësit ta miratojë së paku tre muaj para skadimit të mandatit të drejtorit, përkatësisht të zëvendësit.

(7) Afati për paraqitje në konkursin publik është 15 ditë nga dita e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(8) Për drejtor ose zëvendës emërohet personi me të paktën tetë vjet përvojë pune si gjykatës në gjykata ose prokuror publik në prokuroritë publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, gjykatës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës të Maqedonisë së Veriut ose në një gjykatë ndërkombëtare.

(9) Vitet e përvojës së punës sipas paragrafit (8) të këtij neni do të mbulojnë përvojën e përgjithshme të punës të arritur në organet e përmendura si gjykatës dhe prokuror publik.

(10) Personi kandidat për drejtor përkatësisht zëvendës, krahas cilësive të larta profesionale dhe profesioniste dhe rezultateve në punë, duhet t'i përmbush edhe këto kushte:

- të njohë në mënyrë aktive një nga tre gjuhët më të përdorura të Bashkimit Europian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht), që dëshmohet me posedimin e certifikatës të pranuar ndërkombëtare të lëshuar nga testues zyrtar Europian, anëtar i shoqatës ALTE të testuesve Europianë të nivelit B2 (B2) CEFR (CEFR), përkatësisht IELTS me 5-6 pikë, FCE, BEK C, ILEK, IKFE, BULATS ose APTIS B2 ose TOEFEL PBT të paktën 500 pikë, TOEFEL CBT të paktën 175 pikë ose TOEFEL IBT të paktën 60 pikë ose DELF, TCF, TEF ose certifikata Gete, TestDaF,

- me aktvendim të plotfuqishëm të mos jetë i gjykuar për veprën penale me dënim me burg pa kusht prej të paktën gjashtë muaj dhe

- me aktvendim të plotfuqishëm të mos ketë dënim të shqiptuar ose sanksion kundërvajtës, ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose obligimit për veprë penale ose shkelje lidhur me keqpërdorimin e funksionit të gjykatësit apo prokurorit publik.

(11) Mënyra e emërimit dhe shkarkimit të drejtorit dhe zëvendësit rregullohet më hollësisht me Statut.

Të drejtat dhe detyrat e drejtorit

Neni 16

Drejtori ka këto të drejta dhe detyra:

- menaxhon punën e Akademisë,
- përfaqëson dhe prezanton Akademinë përpara institucioneve vendore dhe ndërkombëtare,
- realizon vendimet e Këshillit drejtues,
- e koordinon dhe e organizon punën e Akademisë,
- kujdeset për sigurimin e kushteve për funksionimin e përditshëm të Akademisë,
- paraqet propozim-program për punën e Akademisë,
- paraqet Raport vjetor për punën e Akademisë,
- merr pjesë në përgatitjen e të gjitha programeve të trajnimit nën kompetencën e Akademisë,

- merr pjesë në punën e Këshillit drejtues dhe kryeson seancat e Këshillit të programit,

- propozon listë të ligjëruesve bazuar në mendimin e Këshillit të programit,

- vendos bashkëpunim me institucionet të përfaqësuara,
- miraton akt për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës,

- menaxhon me Shërbimin e punëve tekniko-profesionale të Akademisë,

- menaxhon me mjetet financiare dhe pasurinë e Akademisë për të cilën e paraqet propozim-planin financiar dhe propozim-planin e furnizimit publik të Këshillit drejtues,

- propozon ndryshime dhe plotësime në Statut dhe akte të tjera të përgjithshme të Akademisë,

- është përgjegjës për ligjshmërinë e funksionimit të Akademisë dhe

- kryen edhe detyra të tjera në pajtim me këtë ligj, Statutin dhe aktet e përgjithshme të Akademisë.

Paga e drejtorit dhe zëvendësit

Neni 17

(1) Paga e drejtorit përcaktohet në nivelin e pagës së gjykatësit në Gjykatën Supreme, të përcaktuar me ligj.

(2) Paga e zëvendësit përcaktohet në nivelin e pagës së gjykatësit në Gjykatën e Apelit, të përcaktuara me ligj.

(3) Drejtori dhe zëvendës drejtori kanë të drejtë të shtesave të pagës për shkak të mbrojtjes së autoritetit të institucionit dhe besueshmërinë në punë, ndërsa lartësia e të cilëve në mënyrë më të përfaqësit rregullohet me akt të Akademisë.

Ndërprerja e mandatit dhe shkarkimi i drejtorit dhe zëvendësit

Neni 18

(1) Drejtorit dhe zëvendësit u ndërpritet mandati:

- për shkak të skadimit të kohës për të cilën janë emëruar;

- për shkak të vdekjes;

- me kërkesën e tij;

- nëse shkarkohet nga pozita e gjykatësit ose prokurorit publik me vendim të plotfuqishëm;

- nëse është vërtetuar paaftësia e përhershme për punë dhe

- duke plotësuar kushtet për pension.

(2) Drejtori dhe zëvendësi shkarkohen përpara skadimit të mandatit për të cilin ata emërohen nëse:

- me aktgjykim të plotfuqishëm i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës për ndalimin e kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës,

- me aktvendim të plotfuqishëm gjyqësor është i dënuar për veprë penale dënim me burgim prej më shumë se gjashtë muaj ose dënim më të shkurtër ose sanksion kundërvajtës që e bën atë të paafitë për të kryer funksionin e drejtorit përkatësisht zëvendësit,

- vepron në kundërshtim me dispozitat e rregullave në fushën e parandalimit të korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

(3) Këshilli drejtues me vendim konstaton hyrjen e kushteve për ndërprerje të mandatit të drejtorit, përkatësisht zëvendësit ose për shkarkimin e tij.

(4) Drejtori, përkatësisht zëvendësi ka të drejtë të nis kontest administrativ para gjykatës kompetente kundër vendimit të Këshillit drejtues për shkarkimin e tij.

(5) Deri në emërimin e drejtorit të ri, por jo më gjatë se tre muaj, detyrën e drejtorit e kryen zëvendësdrejtori.

(6) Nëse Akademia nuk ka zëvendësdrejtor ose mandati i tij ka skaduar, Këshilli drejtues cakton ushtrues detyrës drejtor nga radhët e gjykatësve dhe prokurorëve publikë të cilët janë anëtarë të Këshillit drejtues, për periudhë jo më të gjatë se tre muaj.

(7) Funksinonin anëtar i Këshillit drejtues, në vend të anëtarit i cili është caktuar për ushtrues të detyrës drejtor, e bën zëvendësanëtarin deri në emërimin e drejtorit të ri të Akademisë, por jo më gjatë se tre muaj.

3. Këshilli i programit

Përbërja e Këshillit të programit

Neni 19

(1) Këshilli i programit është organ profesional i Akademisë.

(2) Këshilli i programit përbëhet nga shtatë anëtarë dhe zëvendës të tyre që i emëron Këshilli drejtues.

(3) Për anëtar dhe zëvendësanëtar të Këshillit të programit mund të emërohet:

- gjykatës ose prokuror publik me të paktën tetë vjet përvojë punë si gjykatës dhe/ose prokuror publik,
- profesor ordinar dhe inordinar i shkencave juridike me të paktën tetë vjet përvojë pune në fushë të caktuar juridike, pas marrjes së titullit akademik doktor i shkencave dhe
- udhëheqës nëpunës shtetëror nga Ministria e Drejtësisë me të paktën tetë vjet përvojë pune në fushën e jurisprudencës pas dhënies së provimit të jurisprudencës.

(4) Emërimi i anëtarëve dhe zëvendësve të tyre në Këshillin e programit, duke pasur parasysh biografinë e tyre personale, bëhet në një mënyrë që:

- Këshilli i Prokurorëve Publikë emëron një anëtar dhe zëvendësin e tij nga radhët e prokurorëve publikë,
- Ministri i Drejtësisë emëron një anëtar dhe zëvendësin e tij nga radhët e nëpunësve administrativë udhëheqës në Ministrinë e Drejtësisë.
- Gjykata Supreme në një seancë të përgjithshme emëron një anëtar dhe zëvendësin e tij nga radhët e gjykatësve të Gjykatës Supreme,
- Prokuroria Publike emëron një anëtar dhe zëvendësin e tij nga radhët e Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe
- Këshilli Gjyqësor emëron një anëtar dhe zëvendësin e tij nga radhët e gjykatësve.

(5) Zgjedhja e dy anëtarëve nga radhët e profesorëve ordinar dhe inordinar të shkencave juridike realizohet nëpërmjet një thirrje publike, në bazë të vendimit të Këshillit drejtues.

(6) Mandati i anëtarëve të Këshillit të programit dhe zëvendësve të tyre zgjat katër vjet, me të drejtë për rizgjedhje të njëhershme.

(7) Një muaj para skadimit të mandatit sipas paragrafit (6) të këtij neni, anëtarët dhe zëvendësanëtarët do të emërohen për Këshillin e programit.

(8) Anëtarët e Këshillit të programit dhe zëvendësit e tyre nuk mund të jenë anëtarë dhe zëvendësanëtarë të Këshillit drejtues, Komisionit të provimit pranues (në tekstin e mëtutjeshëm: Komisioni i pranimit), Komisionit të provimit përfundimtar (në tekstin e mëtutjeshëm: Komisioni përfundimtar) dhe Komisionit të revizionit të provimeve të mbajtura.

(9) Anëtarët e Këshillit të programit dhe zëvendësit e tyre mund të jenë ligjërues në Akademi.

Kompetencat e Këshillit të programit

Neni 20

- Këshilli i programit të Akademisë:
- miraton Rregulloren punën e saj,
 - përcakton propozimprogram për provim pranues, trajnim fillestar dhe provim të përfunduar,
 - përcakton propozimprograme për trajnimin e vazhdueshëm (obligues dhe vullnetar),
 - përcakton propozimprogram për gjykatësit e sapoe mësuar në gjykatat themelore dhe prokurorët publikë në prokuroritë themelore publike,
 - përcakton propozimprogram për trajnimet e speci alizuara të gjykatësit të jurisë, nëpunësve gjyqësorë dhe programe të tjera të specializuara,
 - ndjek realizimin e programeve dhe efikasitetin dhe suksesin e tyre,
 - ndjek dhe avanco programet për trajnim,
 - jep udhëzime për metodat dhe teknikat arsimore,
 - jep mendim për listat e ligjëruesve,
 - bën vlerësimin dhe evoluimin e punës së ligjëruesve të Akademisë,
 - bën vlerësimin dhe evoluimin e punës së mentorëve,
 - bën verifikimin e bazave të pyetjeve dhe bazave të studimeve të rastit,
 - jep këshilla, propozime dhe sugjerime organeve të Akademisë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe
 - bën punë të tjera në pajtim me këtë ligj, Statutin dhe aktet e Akademisë.

Mënyra e punës së Këshillit të programit

Neni 21

(1) Seancat e Këshillit të programit thirren dhe me të kryeson drejtori i Akademisë.

(2) Seancat e Këshillit të programit mbahen nëse janë të pranishëm shumica e numrit të përgjithshëm të anëtarëve, ndërsa vendimet miratohen me shumicën e votave.

(3) Në rast kur anëtarin e Këshillit të programit pengohet të marrë pjesë në një seancë të caktuar të Këshillit të programit, është i detyruar të informojë me kohë Akademinë, dhe në seancë thirret zëvendësi i tij për pjesëmarrje të cilit i dorëzohet rendi i ditës dhe materialet për seancën.

(4) Këshilli i programit gjithashtu mund të mbajë seanca edhe nëpërmjet telefonit ose nëpërmjet lidhjes së video konferencës.

(5) Në seancat e Këshillit të programit mund të marrin pjesë ligjërues dhe mentorë, si dhe persona të tjerë që me njohuritë dhe përvojën e tyre profesionale, mund të kontribuojnë në përmirësimin e mësimdhënies në Akademi.

(6) Për çdo seancë mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga drejtori dhe procesverbal.

(7) Procesverbal sipas paragrafit (6) të këtij neni mbahen nga personi i punësuar në Shërbimin e punëve tekniko-profesionale të Akademisë i cili kryhen edhe punë të tjera administrative dhe profesionale për nevoja të Këshillit të programit, të përcaktuara me aktin e sistematizimit të vendeve të punës ose me vendim të drejtorit.

Kompensimi i anëtarëve të Këshillit të programit

Neni 22

(1) Anëtarët e Këshillit të programit, me përjashtim të drejtorit, kanë të drejtë për një kompensim monetar mujor në pajtim me aktet e Akademisë.

(2) Kompensimi sipas paragrafit (1) të këtij neni përcaktohet në pajtim me aktet e Akademisë dhe përcaktohet në bazë të vëllimit të punës së kryer dhe nuk mund të jetë më i lartë se 45% e pagës mesatare mujore të paguar në Republikë në tre muajt e fundit.

(3) Anëtarët e Këshillit të programit, të cilët kanë një vendbanim ose vendqëndrim jashtë selisë së Akademisë, kanë të drejtën e kompensimit të shpenzimeve rrugore reale, në pajtim me aktet e Akademisë.

(4) Kompensimi mujor i parashikuar për punën e anëtarit të Këshillit të programit i paguhet anëtarit dhe zëvendësanëtarit në proporcion me numrin e seancave që mori pjesë në muajin aktual për të cilin bëhet pagesa.

Ndërprerja e mandatit dhe shkarkimi i anëtarit të Këshillit të programit

Neni 23

(1) Anëtarit dhe zëvendësanëtarit të Këshillit të programit i ndërpritet mandati:

- me skadimin e kohës për të cilën është emëruar apo përzgjedhur,

- me kërkesën e tij,

- për shkak vdekjes,

- nëse i ndërpritet funksioni ose marrëdhënia e punës në organin ku e ka kryer funksionin ose punon dhe

- nëse pengohet ta kryejë funksionin më gjatë se gjashtë muaj për ndonjë sëmundje apo arsye të tjera.

(2) Anëtari dhe zëvendësanëtari i Këshillit të programit shkarkohet para skadimit të mandatit për të cilën është emëruar:

- nëse më shumë se dy muaj nuk merr pjesë në seancat e Këshillit të programit pa ndonjë arsye dhe nëse nuk i kryen obligimet e marra dhe

- nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e rregullave të sferës për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit

(3) Më së voni në afat prej 30 ditë nga dita e miratimit të vendimit për shkarkim, përkatësisht ndërprerjes së mandatit të anëtarit, përkatësisht të zëvendësanëtarit në Këshillin e programit, emërohen anëtarë të ri në pajtim me këtë ligj.

(4) Mandati i anëtarit sapoemëruar, përkatësisht të zëvendësanëtarit të Këshillit të programit zgjat deri në skadimin e mandatit të anëtarit përkatësisht zëvendësi në vend të cilit është emëruar.

(5) Deri në emërimin e anëtarit të ri në Këshillin e programit punën e anëtarit do e kryejë zëvendësanëtari.

III. LIGJËRUESIT, MENTORËT DHE KOMISIONI I REVIZIONIT**Ligjëruesit e Akademisë**

Neni 24

(1) Ligjëruesit janë persona profesionalë për zbatimin e programeve për trajnim në Akademinë.

(2) Ligjërues në Akademi mund të jenë gjykatës vendor apo të huaj, prokurorë publikë dhe profesorë universitarë, si dhe avokatë, noterë, ndërmjetës, përmbarues, nëpunës udhëheqës dhe nëpunës të tjerë me përvojë të

administratës, gjyqësorit dhe të prokurorisë publike dhe persona profesionist që kanë përvojë të dëshmuar në fushat e përfshira me programet për trajnim në Akademi.

(3) Për ligjërues mund të përcaktohet edhe personi i cili ka të paktën tetë vjet përvojë pune në fushat e juridikut si gjykatës, prokuror publik ose person profesional në fushën përkatëse.

(4) Lista e ligjëruesve të Akademisë përditësohet të paktën njëherë në vit, duke pasur parasysh:

- cilësinë e trajnimit të realizuar,

- përgatitjen për përfshirje aktive në procesin e trajnimit dhe

- përgatitjen në kohë të programit dhe materialit për trajnim.

(5) Akademia angazhon ligjërues nga lista e ligjëruesve, si dhe ligjërues sipas nevojës.

(6) Për nevojat e procesit edukativ Akademia organizon trajnime për trening të ligjëruesve (trajner) për metodat dhe teknikat e mësimnxënies.

(7) Mënyra e përgatitjes, numri dhe përbërja e listës së ligjëruesve, mënyra e angazhimit, si dhe kriteret e përafërta të evoluimit të ligjëruesve në trajnimet fillestare dhe të vazhdueshme, rregullohet me akt të akademisë.

(8) Si ligjërues në trajnimet fillestare nuk mund të zgjidhen anëtarët e Këshillit drejtues dhe zëvendësit e tyre, anëtarët e Komisionit të revizionit të provimeve të tyre, anëtarët e Komisionit të revizionit të provimeve të mbajtura, si dhe anëtarë të Komisionit përfundimtar dhe zëvendësit e tyre.

(9) Ligjërues në fushën e trajnimit të vazhdueshëm mund të jetë anëtarët e Këshillit drejtues dhe zëvendësit e tyre, drejtori dhe zëvendësi, pa kompensim.

Ligjërues sipas nevojës

Neni 25

(1) Akademia mund të angazhon edhe ligjërues sipas nevojës.

(2) Ligjërues sipas nevojës janë personat profesionistë të cilët angazhohen për trajnim të veçantë ose cikël trajnimesh, në fusha të caktuara juridike si dhe për trajnime mbi tema të përgjithshme dhe fusha komplementare dhe jojuridike, nga radhët e ekspertëve të shquar në fushën përkatëse për të cilën janë angazhuar, si mjekësia, teknologjia kompjuterike, gjuhët e huaja, sociologjia, shkencat e komunikimit, ekonomia, psikologjia dhe shke nca të tjera që lidhen me temat e programeve të trajnimit.

(3) Akademia mban evidencë për ligjëruesit e angazhuar sipas nevojës dhe për këtë një herë në vit e informon Këshillin drejtues.

Kompensimi i ligjëruesve

Neni 26

Ligjëruesit kanë të drejtë për kompensim në varësi të punës së bërë, përkatësisht orëve të realizuara të mësimdhënies, vëllimit të pyetjeve të përgatitura dhe rasteve studimore për provimin, angazhimit në ditët së ekspertizës e të ngjashme, të cilat rregullohen në mënyrë të përafërt rregullohen me akt të veçantë të Akademisë.

Mentorët

Neni 27

(1) Mentorët mund të jenë gjykatës dhe prokurorë publikë, të trajnuar nga mentorë nga ana e Akademisë me të paktën tetë vjet përvojë gjyqësore ose të prokurorisë publike, të vlerësuar vazhdimisht me një vlerësim pozitiv

nga organi që monitoron dhe vlerëson punën e tyre, ndërsa të cilët realizojnë fazën e dytë të trajnimit fillestar - mësimdhënia praktike. Mentorët monitorojnë dhe vlerësojnë punën e dëgjuesve për të cilët janë përgjegjës.

(2) Mentorët përgatisin dëgjuesit për kryerjen e mëvetësishme, të përgjegjshme, të pavarur dhe të paanshme të detyrave të punës.

(3) Lista e mentorëve, me propozim të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë, përcaktohet nga Këshilli drejtues.

(4) Anëtarët dhe zëvendësanëtarët e Këshillit drejtues, Këshillit të programit, Komisionit të pranimit, Komisionit përfundimtar, anëtarëve të Komisionit të revizionit të provimeve të mbajtura, kryetarët dhe anëtarët e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve publikë, si dhe kryetarët e gjykatave dhe prokurorët publikë të prokurorive publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk mund të zgjidhen si mentorët.

(5) Mentorët kanë të drejtë për kompensim në të holla, shumica e të cilit varet nga numri i javëve të mentorimit, dëgjuesit e mentoruar dhe kohëzgjatja e përvojës së tyre të mentorimit.

(6) Kushtet më të hollësishme për kohëzgjatjen e mentorimit, mënyrën e mbajtjes së ditarit të mentorimit, monitorimin e dëgjuesve për mënyrën e përbushjes së përgjegjësisë të detyrave të tyre të punës, vlerësimin e procesit të mentorimit dhe mentorëve, si dhe kompensimin e mentorëve në pajtim me paragrafin (4) të këtij neni rregullohen me një akt të Akademisë.

Komisioni i pranimit dhe Komisioni përfundimtar

Neni 28

(1) Provimi pranues jepet para Komisionit të pranimit, ndërsa provimi përfundimtar jepet para Komisionit përfundimtar.

(2) Anëtarët e Komisionit të pranimit dhe përfundimtar në punën e tyre do të udhëhiqen sipas parimit të objektivitetit, sekretit dhe barazisë ndaj kandidatëve.

(3) Komisionet sipas paragrafit (1) të këtij neni i mbajnë provimet në përbërje të plotë.

(4) Komisionet sipas paragrafit (1) të këtij neni përbëhen nga shtatë anëtarë dhe zëvendësit e tyre, me mandat prej një sesioni të provimeve për një gjeneratë të kandidatëve, me të drejtë për një përzgjedhje tjetër.

(5) Këshilli drejtues emëron komisionet sipas paragrafit (1) të këtij neni me këtë përbërje: dy anëtarë dhe zëvendësit e tyre me propozim të Këshillit Gjyqësor nga radhët e gjykatësve, dy anëtarë dhe zëvendësit e tyre me propozim të Këshillit të prokurorëve publikë nga radhët e prokurorëve publikë, një anëtar dhe zëvendësin e tij nga Shoqata e gjykatësve, një anëtar dhe zëvendësin e tij nga Shoqata e prokurorëve publikë, një anëtar dhe zëvendësin e tij me propozim të ministrit të Drejtësisë nga radha e nëpunësve administrativë udhëheqës në Ministrinë e Drejtësisë.

(6) Për anëtarë dhe zëvendësanëtarë të komisioneve sipas paragrafit (1) të këtij neni mund të emërohen gjykatës dhe prokurorë publikë me të paktën gjashtë vite përvojë në gjykatë apo prokurori publikë si dhe nëpunës udhëheqës administrativ në Ministrinë e Drejtësisë me gjashtë vite përvojë pune në pozicion udhëheqës që në karrierën e deriatëhershme profesionale shquhen me profesionalizmin e tyre, etikën, rezultatet e dëshmuara në punë dhe që kanë prestigj të lartë në gjyqësor.

(7) Këshilli drejtues i cakton seancat konstituive të këtyre komisioneve sipas paragrafit (1) të këtij neni ku anëtarët e komisioneve zgjedhin kryetarin nga radhët e gjykatësve dhe prokurorëve publikë.

(8) Anëtarët dhe zëvendësit e Këshillit drejtues, Këshillit të programit, Komisionit të revizionit të provimave të mbajtura dhe drejtori e zëvendësi, si dhe ligjëruesit dhe mentorët që në atë periudhë janë angazhuar në trajnim fillestar, nuk mund të jenë anëtarët të këtyre komisioneve sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(9) Anëtari i Këshillit Gjyqësor ose Këshillit të prokurorëve publikë nuk mund të jetë anëtar ose zëvendësanëtar i këtyre komisioneve sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(10) Anëtari ose zëvendësanëtari i Komisionit të pranimit nuk mund të jetë anëtar ose zëvendësanëtar në Komisionin përfundimtar dhe anasjelltas.

(11) Komisionet sipas paragrafit (1) të këtij neni kanë sekretar dhe ndihmës të tij nga radhët e personave të punësuar në Shërbimin e çështjeve tekniko-profesionale të Akademisë, të përcaktuar me vendim të drejtorit.

(12) Për rrjedhën dhe procedurën e dhënies së provimit pranues, përkatësisht provimit përfundimtar, kryetarët e komisioneve sipas paragrafit (1) të këtij neni deri të Këshilli dorëzojnë raport.

(13) Këshilli drejtues miraton raportet sipas paragrafit (11) të këtij neni në mënyrën e përcaktuar me Statutin e Akademisë.

(14) Anëtarët e Komisionit të pranimit dhe Komisionit përfundimtar kanë të drejtë të kompensimit në të holla, në pajtim me aktet e Akademisë.

Komisioni i revizionit të provimeve të mbajtura

Neni 29

(1) Këshilli drejtues emëron anëtarët e Komisionit të revizionit të provimeve të mbajtura, të cilat jepen në pajtim me këtë ligj, në një përbërje prej pesë anëtarësh, edhe atë nga një anëtar në propozim të: Këshillit Gjyqësor, Këshillit të Prokurorëve Publikë, Gjykatës Supreme, Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ministrisë së Drejtësisë, me mandat prej një sesioni të provimit për një gjeneratë të kandidatëve, me të drejtë për një përzgjedhje tjetër.

(2) Anëtarët e Komisionit të revizionit të provimeve të mbajtura nuk guxon të zgjidhen anëtarë të Këshillit drejtues, Këshillit të programit, Komisionit të pranimit, Komisionit përfundimtar, mentor, ligjërues në trajnim fillestar ose drejtor dhe zëvendës.

(3) Komisioni sipas paragrafit (1) të këtij neni mund të monitorojë drejtpërdrejt mbajtjen e provimeve ose pasi secili provim të mbajtur të kryejë një kontroll të plotë të mënyrës së kryerjes së provimeve të parashikuara me këtë ligj.

(4) Komisioni i revizionit të provimeve të mbajtura në punën e tij përdor materialet nga provimet e mbajtura, kryen shqyrtimin e testeve dhe rasteve studimore për dhënien e provimit, si dhe regjistrimet nga provimet e mbajtura që ruhen në Akademi.

(5) Komisioni i revizionit të provimeve të mbajtura miraton rregulloren e punës për punën e tij, me të cilën në mënyrë më të përafërt rregullohet mënyra e punës dhe miratimi i vendimeve.

(6) Komisioni i revizionit të provimeve të mbajtura, në seancën e parë, zgjedh kryetarin nga radhët e anëtarëve të tij.

(7) Komisioni i revizionit të provimeve të mbajtura dorëzon raport deri te Këshillit drejtues për mënyrën dhe rrjedhën e provimeve të mbajtura i cili gjithashtu mund të përmbajë rekomandime në lidhje me rrjedhën e ardhshme të procesit e provimit, në pajtim me ligjin.

(8) Kryetari dhe anëtarët e Komisionit të revizionit të provimeve të mbajtura kanë të drejtë të kompensimit nga revizioni i kryer, ndërsa lartësia e të cilës në mënyrë më të përafërt rregullohet me akt të Akademisë.

IV. TRAJNIMI I KANDIDATËVE PËR GJYKATËS DHE PROKURORË PUBLIKË

1. Pranimi në trajnimin fillestar

Dëgjuesit në trajnimin fillestar

Neni 30

(1) Trajnimi fillestar organizohet me qëllim të përvetësimit të njohurive dhe aftësive praktike dhe teorike, me qëllim krijimin e kandidatëve të trajnuar, të pavarur, profesionistë dhe efikas, që posedojnë integritet dhe ndërgjegje në punën e tyre, për gjykatës dhe prokurorë publikë në gjykatat themelore dhe prokuroritë themelore publike, si parakusht për respektimin e parimit të zotërimit të drejtësisë dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut për krijimin e cilësisë së drejtësisë në interes të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë më së voni deri më 31 mars të vitit aktual dorëzojnë pranë Akademisë vendime për numrin e vendeve të lira të gjykatësve dhe prokurorëve nëpër gjykatat themelore dhe prokuroritë themelore publike, së bashku me vlerësimin e nevojave të burimeve njerëzore nga fushat e apelit për dy vitet e ardhshme.

(3) Këshilli drejtues i Akademisë me vendim përcakton fillimin e zbatimit të provimit pranues për trajnimin fillestar dhe numrin e dëgjuesve që do të regjistrohen në atë gjeneratë të trajnimit fillestar, në bazë të vendimeve të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë sipas paragrafit (2) të këtij neni.

(4) Dëgjuesit e trajnimit fillestar janë personat të cilët, pas dhënies së provimit pranues, pranohen në trajnimin fillestar sipas listës së përcaktuar të renditjes.

Kushtet për pranim në trajnimin fillestar

Neni 31

(1) Kushtet për pranim në trajnimin fillestar:

- të jetë jurist i diplomuar me katër vjet arsimi të lartë shkalla VII/I e studimeve juridike ose jurist i diplomuar me 300 kredi sipas sistemit European të transferimit të kredive (SETK)

- të ketë provim të dhënë jurisprudencës,
- të ketë përvojë pune prej të paktën dy viteve me punë juridike pas dhënies së provimit të jurisprudencës,
- të mos ketë të shqiptuar masë sigurie ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
- të jetë qytetar i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- të zotërojë në mënyrë aktive gjuhën maqedonase,
- të dijë një nga tre gjuhët më të përdorura të Bashkimit European (anglisht, frëngjisht ose gjermanisht), që përcaktohet në suazat e provimit pranues në Akademi,
- të ketë dije për punë praktike me kompjuterë dhe
- të jetë i aftë për punë dhe të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore.

(2) Lloji i dokumenteve të cilat duhet të bashkëngjitet në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni rregullohet me akt të Akademisë.

Shpallja publike për pranim në trajnimin fillestar

Neni 32

(1) Këshilli drejtues miraton vendim për shpalljen e shpalljes publike për pranim të dëgjuesve në trajnimin fillestar.

(2) Këshilli drejtues mund të marrë vendim për shpalljen e shpalljes publike sipas paragrafit (1) të këtij neni edhe në fushën e apelit në bazë të vendimeve të paraqitura nga Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë.

(3) Shpallja publike sipas paragrafit (1) dhe (2) të këtij neni botohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të paktën në dy gazeta ditore, nga të cilat njëra nga gazetat që botohen është në gjuhën maqedonase dhe njëra nga gazetat që botohen në një gjuhë që e flasin të paktën 20% e qytetarëve, ndërsa flasin gjuhë zyrtare ndryshe nga gjuha maqedonase, si dh shpallet në ueb faqen e Akademisë.

(4) Afati për paraqitje të personave në shpalljen publike është 15 ditë, e llogaritur nga dita e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(5) Në shpalljen për pranim të dëgjuesve në fushën e apelit, një person mund të paraqitet në shpalljen vetëm për një fushë të apelit. Procedura e selektimit dhe renditjes së kandidatëve për gjykatës dhe prokurorë publikë rregullohet për secilin fushë të apelit në veçanti.

E drejta e ankesës së parashtruesit

Neni 33

(1) Pas skadimit të afatit të paraqitjes, Komisioni i pranimit me aktvendim do t'i refuzojë paraqitjet e parakohshme dhe të parregullta.

(2) Parashtruesi i paraqitjes në afat prej dy ditë pune nga dita e pranimit të aktvendimit sipas paragrafit (1) të këtij neni ka të drejtë të ankesës deri te Këshilli drejtues.

(3) Këshilli drejtues, vendimin ndaj ankesës e miraton në afat prej dy ditë pune.

Mësimdhënia përgatitore

Neni 34

(1) Akademia organizon mësimdhënie përgatitore për të gjithë personat e paraqitur për pranim në Akademi.

(2) Mësimdhënia përgatitore organizohet së paku 30 ditë para ditës së mbajtjes së provimit pranues.

Provimi pranues

Neni 35

(1) Provimi pranues për trajnimin fillestar përbëhet nga dhënia e:

- testit për nivelin e njohjes së njërës prej tre gjuhëve më të përdorura të Bashkimit European (anglisht, frëngjisht ose gjermanisht)

- testit psikologjik
- testit të integritetit
- testit të kualifikimit dhe
- provimit praktik.

(2) Testimi zhvillohet me orar ashtu siç janë përmendur testet në paragrafin (1) të këtij neni dhe çdo pjesë është eliminatorë.

(3) Dhënia e pjesëve me shkrim nga provimi pranues zbatohet në mënyrë anonime për çka Akademia kandidatit i jep shifër provimi.

(4) Akademia obligohet gjatë zbatimit të provimit pranues, sidomos gjatë zbatimit të testit psikologjik dhe testit të integriteti të kujdeset për mbrojtjen e të dhënave personale, autoritetin dhe dinjitetin e kandidatëve, në pajtim me ligjin.

(5) Me kërkesë të personave që i kanë dhënë provimet të parashikuar me këtë ligj, Akademia u mundëson kontroll të drejtpërdrejtë në teste dhe shembujt praktik dhe materialet e tjera që kanë qenë pjesë e provimeve përveç për testin psikologjik dhe testin e integritetit.

(6) Për rrjedhën e dhënies së provimit të çdo pjese të provimit pranues, sekretari i Komisionit të pranimit mban procesverbal në të cilin evidentohen të gjitha hapat e ndërmarra gjatë tërë procedurës së dhënies së testit, të cilën e nënshkruajnë kryetari, të gjithë anëtarët e Komisionit të pranimit dhe sekretari.

Procedura për dhënie të provimit pranues

Neni 36

(1) Procedura për dhënie e provimit pranues realizohet në pajtim me Programin për provim pranues i cili shpallet së paku tre muaj para dhënies së provimit pranues.

(2) Mënyra dhe kushtet më të përafërta për dhënie e provimit në pjesë të caktuara të provimit pranues, rregullohen me Statut dhe me aktet e Akademisë.

Testi për njohjen e gjuhëve të huaja

Neni 37

(1) Testi për nivelin e njohjes të njërës prej tre gjuhëve më të përdorura të Bashkimit Europian (anglisht, frëngjisht ose gjermanisht) jepet me shkrim dhe synon të kontrollojë nivelin e njohjes të një gjuhe të huaj përkatësisht nëse kandidatët kanë nivel të njohurive B1.

(2) Testi përbëhet nga njëqind pyetje që janë të fushës së gramatikës, kuptimit dhe aftësia e të shprehurit.

(3) Pyetjet dhe përgjigjet e ofruara përgatiten nga ligjëruesit e gjuhëve të huaja të Akademisë ose profesorë të tjerë të akredituar të gjuhëve të huaja.

(4) Mënyra e kontrollimit të njohjes në mënyrë më të përafërt rregullohet me akt të veçantë të Akademisë.

(5) Kandidatët njoftohen me shkrim dhe përmes formës elektronike a e kanë dhënë provimin.

(6) Kundër rezultateve të testit për njohje aktive të një nga tre gjuhë më të përdorura në Bashkimin Europian (anglisht, frëngjisht ose gjermanisht) nuk lejohet ankesë e veçantë.

(7) Nëse kandidati nuk e kalon provimin, ai e humb të drejtën për dhënie e mëtejshme të provimit.

Testit psikologjik dhe testit të integritetit

Neni 38

(1) Testi psikologjik synon të vlerësojë aftësitë sociale të kandidatëve për të kryer funksionin e gjykatësit dhe prokurorit publik.

(2) Testi i integritetit synon të kontrollojë vlerat etike dhe morale të kandidatit, bazuar në kodet etike dhe profesionale për kryerjen e funksionit gjykatës ose prokuror publik dhe realizohet në bazë të listës standarde të vërtetuar të pyetjeve me identitetit të mbrojtur.

(3) Testi psikologjik dhe testi i integritetit vlerësohen me notë "të kënaqshëm" dhe "të pakënaqshëm".

(4) Personi i paraqitur që ka marrë notë "të pakënaqshme" në testin psikologjik konsiderohet se nuk e ka kaluar atë dhe humb të drejtën e dhënies së mëtejshme të provimit.

(5) Personi i paraqitur që ka marrë notë "të pakënaqshme" në testin e integritetit nuk mund të marrë testin e kualifikimit përkatësisht e humb të drejtën për dhënie e mëtejshme të provimit.

(6) Kundër rezultateve të testit psikologjik dhe testit të integritetit nuk lejohet ankesë e veçantë.

(7) Për zbatimin e testit psikologjik dhe testin e integritetit, Akademia angazhon persona profesional nga institucion profesional i pavarur dhe plotësisht i akredituar.

(8) Testet sipas paragrafit (1) të këtij neni zbatohen në bazë të testeve të pranuar ndërkombëtare për kryerjen e funksionit gjykatës dhe prokuror publik.

Testit të kualifikimit

Neni 39

(1) Testi i kualifikimit jepet në mënyrë elektronike me qëllim të kontrollit të njohurisë së kandidatëve të paraqitur nga fusha e së drejtës materiale dhe procesuale, të së drejtës ndërkombëtare, të së drejtës së BE-së dhe aktgjykimet më të rëndësishme të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

(2) Testi i kualifikimit përmban njëqind pyetje, prej të cilave:

- 20 nga fusha e së drejtës penale;
- 30 nga fusha e së drejtës civile;
- 15 nga fusha e së drejtës ndërkombëtare;
- 15 nga fusha e së drejtës së BE-së;
- 10 nga fusha e së drejtës kushtetuese;
- 10 nga fusha e së drejtës administrative.

(3) Pyetjet dhe përgjigjet e ofruara i përgatisin ligjëruesit e Akademisë, ku për çdo fushë të caktuar përgatiten të paktën 10 herë më shumë pyetje nga numri i paraparë i pyetjeve për testin e kualifikimit.

(4) Ligjëruesit sipas paragrafit (3) të këtij neni përgatisin nga tre përgjigje për çdo pyetje, kështu që njëra është e saktë dhe sjellë pikë.

(5) Pyetjet e përgatitura së bashku me përgjigjet e ofruara (çelësi) kanë karakter të sekretit zyrtar me nivel të brendshëm.

(6) Pyetjet e përgatitura ligjëruesit i fusin në sistemin elektronik për dhënie e provimit.

(7) Ligjëruesit që i përgatisin pyetjet dhe studimet e rastit, nënshkruajnë deklaratë për konfidencialitet dhe mbajnë përgjegjësi nëse e shkelin këtë obligim.

Mënyra e zbatimit të testit të kualifikimit

Neni 40

(1) Testi jepet në hapësirë për dhënie e provimit, posaçërisht e pajisur për dhënie e provimit me pajisje materiale- teknike dhe informatike, lidhje interneti dhe pajisja për incizimin e dhënies së provimit.

(2) Dhënia e provimit bëhet para Komisionit të pranimit me përbërje të plotë dhe incizohet.

(3) Sistemi elektronik i dhënies së testit nuk mund të lejojë ekzistimin e përmbajtjes identike të testit elektronik për më shumë se një kandidat në grupi në të cilën japin provimin.

(4) Rezultatet nga dhënia e testit janë të disponueshme për kandidatin në kompjuterin ku e ka dhënë provimin, menjëherë pas mbarimit të tij.

(5) Pas mbarimit të testimit elektronik shpallen rezultatet e kandidatëve të shprehura në pikë nën shifrat e tyre të provimit.

(6) Mënyra e realizimit të testit të kualifikimit në mënyrë më të përafërt rregullohet me akt të Akademisë.

Sistemi elektronik për dhënien e testit

Neni 41

Realizimi i testeve që jepen në mënyrë elektronike në pajtim me këtë ligj, personi i autorizuar juridik që teknikisht e realizon provimin, obligohet ta bllokojë perimetrimin e radio- frekuencës në hapësirën e dhënies së provimit gjatë realizimit të sesioneve të provimeve.

Sistemi i vetëm elektronik i testeve

Neni 42

(1) Pyetjet të përfshira në testin e kualifikimit dhe praktik për dhënien e provimit dhe përgjigjet e tyre ruhen në sistemin e vetëm elektronik për teste.

(2) Sistemi i vetëm elektronik përmban bazë të qasjes publike prej më së paku 1000 pyetje nga fusha e lëndëve të përcaktuara, për nevojat e përgatitjes për testin e kualifikimit të cilët shpallen publikisht dhe ripërtërihen njëherë në vjet.

(3) Sistemi elektronik sipas paragrafit (1) të këtij neni përmban bazë të disponueshme publike prej së paku 300 studime të rastit, të cilat janë në peshë dhe ndërlikueshëmi të përafërt, prej të cilave 150 penale dhe 150 civile, të përpiluara nga ana e ligjëruesve.

Pamundësia teknike e sistemit elektronik për të funksionuar

Neni 43

(1) Nëse gjatë dhënies së provimit paraqiten probleme teknike me kompjuterin, të cilat eliminohen më së shumti për pesëmbëdhjetë minuta, provimi i kandidatit zgjatet për të njëjtën periudhë kohore, dhe nëse nuk hiqen brenda kësaj periudhe, provimi vetëm për atë kandidat ndërpritet dhe do të mbahet brenda maksimumi tre ditë nga dita e ndërprerjes së provimit.

(2) Nëse ka probleme me më shumë se gjysmën e kompjuterëve dhe ato nuk eliminohen brenda pesëmbëdhjetë minutash, provimi ndërpritet për të gjithë kandidatët që marrin pjesë në provim dhe do të mbahet brenda maksimumi tre ditë nga dita e ndërprerjes së provimit.

(3) Personat e autorizuar që realizojnë provimin, gjatë dhënies së provimit nuk guxojnë të ndalojnë në afërsi të kandidatit që e jep provimin, përveç në rast të eliminimit të problemeve teknike, ndërsa informatikani nuk guxon të ndalet më shumë se dhjetë minuta.

Vlerësimi i testit të kualifikimit

Neni 44

(1) Në testin e kualifikimit mund të arkëtohen më së shumti 100 pikë.

(2) Përgjigjja e saktë në çdo pyetje sjell 1 pikë, ku çdo pyetje veçmas e testit mund të përgjigjet me selektimin e vetëm një nga tre përgjigjet e ofruara.

(3) Konsiderohet që personi i paraqitur që ka marrë 60 pikë ose më pak në testin e kualifikimit, nuk e ka kaluar testin e kualifikimit dhe nuk ka të drejtë ta japë pjesën e mbetur të provimit pranues.

Provimi praktik

Neni 45

(1) Provimi praktik ka për qëllim kontrollin e njohurive të përgjithshme juridik dhe aftësive të kandidatëve për pranim dhe ndjekjen e programit për trajnim fillestar ndërsa përbëhet nga:

- pjesa me shkrim dhe

- pjesa me gojë.

(2) Provimi praktik jepet në afat prej dhjetë ditëve nga shpallja e rezultateve përfundimtare të testit të kualifikimit.

(3) Pjesa me shkrim përbëhet nga detyra e provimit për zgjidhjen e dy studimeve të rasteve (një nga lënda penale dhe një nga lënda civile gjyqësore).

(4) Në pjesën me gojë të provimit praktik, secili anëtar i Komisionit të pranimit mund t'i parashtrojë kandidatit nga një pyetje në lidhje me materien e studimeve të rasteve.

(5) Mënyra e dhënies së provimit me shkrim dhe me gojë të provimit praktik rregullohet me akt të Akademisë.

(6) Përzgjedhja e studimeve të rasteve bëhet me short.

(7) Pjesa me gojë e provimit zhvillohet nga ana e Komisionit të pranimit në afat maksimumi prej shtatë ditësh pune pas përfundimit të pjesës me shkrim dhe e njëjta incizohet.

(8) Mënyra e pikësimit të provimit rregullohet me akt nënligjor të Akademisë.

(9) Në pjesën me shkrim të provimit, kandidatët mund të marrin maksimumi 70 pikë (35 pikë nga çështjet gjyqësore penale dhe 35 pikë nga çështjet gjyqësore civile).

(10) Kriteret më të afërta sipas të cilave secili anëtar i Komisionit të pranimit vlerëson pjesën me shkrim të provimit, rregullohet me akt nënligjor të Akademisë.

(11) Pikët përfundimtare nga pjesa me shkrim e provimit praktik llogariten në një mënyrë që një mesatare aritmetike llogaritet nga shuma totale e pikëve të marra nga secili anëtar i Komisionit të pranimit, i ndarë me numrin e anëtarëve të komisionit, shprehen me numra deri decimalet e dyta.

(12) Vlerësimi sipas paragrafit (9) të këtij neni kryhet në rastet studimore të anonimuara me një shifër.

(13) Në pjesën me gojë të provimit, kandidatët mund të marrin maksimumi 30 pikë, me çka secilin anëtar i Komisionit të pranimit e vlerëson përgjigjen e kandidatit me maksimumi pesë pikë.

(14) Pikët përfundimtare nga pjesa me shkrim e provimit praktik llogariten në një mënyrë që një mesatare aritmetike llogaritet nga shuma totale e pikëve të marra nga secili anëtar i Komisionit të pranimit, i ndarë me numrin e anëtarëve të komisionit, shprehen me numra deri decimalet e dyta.

(15) Në provimin praktikë mund të fitohen më së shumti 100 pikë.

Përcaktimi dhe shpallja e rezultateve nga provimi praktik dhe të kualifikimit

Neni 46

(1) Në bazë të rezultateve të marra nga dy pjesët e provimit përkatësisht përmbledhja e tyre aritmetike, Komisioni i pranimit përgatit listë të renditjes preliminare dhe e shpall atë publikisht në afat prej dy ditëve pune pas dhënies të provimit, për të cilën Komisioni i pranimit përpilon procesverbal të cilën e nënshkruajnë anëtarët e Komisionit të pranimit dhe sekretari.

(2) Në bazë të rezultateve të fituara nga dy pjesët e provimit fitohet nota përfundimtare e cila paraqet përmbledhje e tyre aritmetike, ndërsa nota e cila fitohet në mënyrë që numri i pikëve të fituara përpjesëtohet me 10.

(3) Në të dy pjesët e provimit mund të fitohen maksimum 200 pikë përkatësisht nota 20.

(4) Procesverbali llogaritet si i besueshëm nëse nënshkruhet nga shumica e anëtarëve të cilët duhet të nënshkruhen.

(5) Lista e renditjes shpallet në tabelën për shpallje dhe në ueb faqen e Akademisë.

E drejta e ankesës së rezultatit të arritur në testim

Neni 47

(1) Kandidati që konsideron se përmbledhja e pikëve nga testi i kualifikimit dhe provimi praktik është llogaritur gabimisht ka të drejtë të ankesës pranë Komisionit të pranimit në afat prej një dite pune nga dita e publikimit të rezultateve në ueb faqen dhe tabelën e shpalljeve të Akademisë.

(2) Komisioni i pranimit është i detyruar ndaj ankesës të vendos në afat prej tre ditë pune duke llogaritur nga dita e pranimit të ankesës.

(3) Kundër vendimit të Komisionit sipas paragrafit (2) të këtij neni, kandidati ka të drejtë ankese pranë Këshillit drejtues në afat prej tre ditë pune, nga dita e pranimit të vendimit.

(4) Këshilli drejtues vendimin lidhur me ankesën e merr më së voni në afat prej tre ditë pune, duke llogaritur nga skadimi i afatit për dorëzimin e ankesës kundër vendimeve të Komisionit të pranimit.

(5) Kundër vendimit të Këshillit drejtues sipas paragrafit (4) të këtij neni, kandidati i pakënaqur në afat prej tre ditë nga dita e pranimit të vendimit, mund të nis kontest administrativ para Gjykatës Administrative.

(6) Ndaj padisë sipas paragrafit (5) të këtij neni Gjykata Administrative vendos në afat prej pesë ditëve.

(7) Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të paragrafit (6) lejohet ankesa pranë Gjykatës së Lartë Administrative në afat prej tre ditë nga dita e pranimit të vendimit të Gjykatës Administrative.

(8) Gjykata e Lartë Administrative ndaj ankesës sipas paragrafit (7) të këtij neni vendos në afat prej pesë ditë nga pranimi i ankesës.

Pranimi i dëgjuesve

Neni 48

(1) Pas hyrjes në fuqi të vendimit nga neni 47 të këtij ligji, Komisioni pranues shpall listën e renditjes me rezultatet përfundimtare të kandidatëve që e kanë kaluar provimin në ueb faqen e Akademisë.

(2) Pranimi i kandidatëve bëhet në bazë të renditjes së suksesit të listës së renditjes deri në plotësimin e numrit të parashikuar të dëgjuesve të përcaktuar me vendim sipas nenit 30, paragrafi (3) të këtij ligji.

(3) Plotësimi i numrit të parashikuar të dëgjuesve bëhet nëse kandidatët kanë fituar të paktën 70% të numrit të përgjithshëm të pikëve në provimin pranues.

(4) Nëse disa kandidatë kanë të njëjtën notë përfundimtare, përparësi ka kandidati i cili ka përvojë më të gjatë në çështjet juridike pas kalimit të provimit të jurisprudencës kurse nëse janë të njëjtë, përparësi ka kandidati që ka pasur notë mesatare më të mirë të studimeve.

(5) Nëse kandidati i pranuar heq dorë nga trajnimi fillestar, është i obliguar ta informojë Akademinë për këtë më së voni 15 ditë para fillimit të mësimi teorik.

(6) Në rastin e paragrafit (5) të këtij neni, Akademia e plotëson atë vend të zbrazët me kandidatin e parë të ardhshëm nga rang lista përfundimtare e dëgjuesve për trajnimin fillestar.

(7) Parimi i përfaqësimit adekuat dhe të drejtë të qytetarëve realizohet në bazë të vendimit të Këshillit drejtues, që numri i dëgjuesve nga radhët e qytetarëve që i përkasin të gjitha bashkësive të Republikës së Maqedonisë së Veriut të përcaktohet në lidhje me numrin e përgjithshëm të dëgjuesve nga të gjitha zonat e apelit.

Mënyra e veprimit me dokumentet e provimeve dhe ruajtja e tyre

Neni 49

(1) Materialet nga provimet, të dorëzuara nga kandidati, do të bashkëngjiten në dosjen personale të kandidatëve të suksesshëm në Akademi dhe me ato veprohet në pajtim me Ligjin e Mbrojtjes së të Dhënave Personale dhe Ligjin e Qasjes së Lirë në Informacione me Karakter Publik, ndërsa ruhen sipas rregullave për punë arkivore.

(2) Përjashtimi sipas paragrafit (1) të këtij neni është nëse testet dhe materialet janë objekt i procesit gjyqësor.

(3) Kandidatëve që nuk e kanë kaluar testin u kthehen dokumentet e bashkangjitura në paraqitje kurse testet e tyre dhe materialet e tjera të provimit si dhe incizimet nga provimi elektronik mbahen në arkiv sipas rregullave për punën arkivore.

2. Trajnimi fillestar**Statusi i dëgjuesve në trajnimin fillestar**

Neni 50

(1) Me marrjen e statusit të dëgjuesit në trajnimin fillestar në Akademi, i trajnuari themelon marrëdhënie pune me kohë të caktuar me Akademinë për periudhën e kryerjes së trajnimit fillestar deri në zgjedhjen e një gjykatësi ose prokurori publik, për të cilin periudhën vlejshme rregulloret e përgjithshme për marrëdhënie pune, sigurimit shëndetësor dhe ky Ligj.

(2) Gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënies së punës sipas paragrafit (1) të këtij neni, dëgjuesi i trajnimit fillestar ka të drejtë të pagës së këshilltar i lartë gjyqësor/prokurorisë publike në gjykatë themelore/prokuroria themelore publike dhe kompensime të tjera të pagës në pajtim me ligjin.

(3) Mënyra e kryerjes së trajnimit fillestar, si dhe të drejtat dhe detyrimet e dëgjuesve të trajnimit fillestar rregullohen me Statutin dhe aktet e Akademisë.

(4) Pas kalimit të provimit përfundimtar, kandidatët për gjykatës dhe prokurorë publikë do të qëndrojnë me marrëdhënie pune në Akademi deri në zgjedhjen e tyre si gjykatës ose prokurorë. Gjatë asaj kohe, kandidatët për gjykatës dhe prokurorë publikë shpërndahen në punë në gjykata, përkatësisht prokuroritë publike në koordinim me Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin e Prokurorëve Publikë dhe në bazë të programi të specializuar të miratuar nga Akademia.

(5) Nëse dëgjuesi gjatë trajnimit fillestar heq dorë, e ndërpret trajnimin ose nuk e përfundon me sukses është i detyruar të kompensojë shpenzime dhe kompensimet e tjera për trajnimin e tij pas një përllogaritje të përcaktuar të shpenzimeve reale, në pajtim me aktet nënligjore të Akademisë.

(6) Dëgjuesi i trajnimit fillestar nuk do të kompensojë shpenzimet e përmendura në paragrafin (5) të këtij neni nëse ka hequr dorë ose ndërprerë trajnimin për arsye shëndetësore, personale ose të një anëtarit të ngushtë të familjes me të cilin jeton, e cila pamundëson ndjekjen e trajnimit për më shumë se dy muaj, e cila dëshmohet me vërtetim mjekësor dhe dokumentacion tjetër përkatës.

(7) Në rast të nevojës për shfrytëzim të pushimit mjekësor të lindjes, përkatësisht pushimit mjekësor më të gjatë se 60 ditë, e cili do të ndodhë menjëherë para fillimit të mësimi teorik, dëgjuesi i trajnimit fillestar fillon të dëgjojë mësimin teorik me gjeneratën tjetër të rregullt të

dëgjuesve të trajnimit fillestar. Në atë rast, me qëllim të ruajtjes së numrit të përcaktuar të kandidatëve për gjykatës dhe prokurorë publikë të publikuar me njoftimin për gjeneratën aktuale, vendi i tij do të plotësohet me dëgjuesin tjetër nga lista përfundimtare e kandidatëve në pajtim me nenet 7 dhe 48 të Ligjit të Akademisë së Gjykatësve dhe të Prokurorëve Publikë.

(8) Dëgjuesi i cili e përdor të drejtën të fillojë të dëgjojë mësimin teorik me gjeneratën e ardhshme të dëgjuesve në trajnimin fillestar në rast shfrytëzimit të mungesës së lindjes, përkatësisht pushimit mjekësor më të gjatë se 60 ditë, të drejtat e marrëdhënies së punës do t'i shfrytëzojë nga momenti i nënshkrimit të kontratës së punës me Akademinë në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni me dëgjuesit e tjerë të gjeneratës tjetër.

Përmbajtja dhe kohëzgjatja e trajnimit fillestar

Neni 51

(1) Trajnimi fillestar përfshin zbatimin e ligjeve materiale dhe procedurale, praktikën gjyqësore dhe të prokurorisë publike dhe etikën, standardet juridike ndërkombëtare dhe Europiane, të drejtat e njeriut, punime shkencore dhe profesionale në fushën e së drejtës vendore dhe ndërkombëtare, si dhe aftësitë e funksionit të gjykatësit dhe prokurorit publik.

(2) Trajnimi fillestar për dëgjuesit zgjat 24 muaj dhe zhvillohet në dy faza, edhe atë:

- faza e parë - mësim teorik në Akademi e cila zgjat nëntë muaj dhe

- faza e dytë - mësimi praktik në gjykata dhe prokurori publike dhe institucione të tjera, në pajtim me programin për trajnimin fillestar në kohëzgjatje prej 15 muaj.

(3) Gjykata, përkatësisht prokuroria publike në të cilën dëgjuesi do ta ndjekë fazën e dytë të trajnimit fillestar përcaktohet në mënyrë rajonale, në pajtim me zonat e apelit në të cilën dëgjuesi ka vendbanimin, përkatësisht vendqëndrim përkatësisht në zonën e apelit për të cilën është paraqitur në konkurs.

(4) Mentorët e obliguar për punë me dëgjuesit janë të obliguar të mbajnë llogari për ardhjen e rregullt në punë, përmbushja e programit të planifikuar, detyrimeve të punës dhe përparimin e dëgjuesve për çka dorëzojnë raporte javore të rregullta në Akademi.

Vlerësimi i trajnimit fillestar (faza e parë)

Neni 52

(1) Lëndët që mësohen gjatë mësimin teorik ndahen në tre module që realizohen dhe jepet provimi radhazi.

(2) Vlerësimi i suksesit të arritur bëhet me teste për kontrollimin e njohurive që kryhen pas përfundimit të secilit modul individual të mësimin teorik.

(3) Përmbajtja e testeve, mënyra e vlerësimit dhe kalimi i secilit prej moduleve rregullohen më hollësisht me një akt të veçantë të Akademisë.

(4) Në rast se dëgjuesit nuk kalojnë me sukses një ose më shumë module, në fund të mësimin teorik ata kanë mundësinë të përsërisin testin edhe një herë në fund të tre moduleve për modulin në të cilin nuk kanë kaluar.

(5) Në bazë të rezultateve të përmbledhura nga testimi pas mbarimit të mësimin teorik, përpilohet një rang listë e dëgjuesve dhe ajo publikohet në ueb faqen e Akademisë.

(6) Numri maksimal i pikëve të fituara nga të tre modulet është gjithsej 30 pikë. Kandidati i cili, edhe pas ritestimit, nuk merr 21 pikë si numrin minimal të përcaktuar të pikëve, i ndërpritet statusi dëgjues i trajnimit fillestar.

Vlerësimi i trajnimit fillestar (faza e dytë)

Neni 53

(1) Pas mbarimit të provimit me sukses të pjesë teorike të trajnimit fillestar, dëgjuesit vazhdojnë me fazën e dytë - mësimin praktik e cila i përfshinë pjesën e punës praktike të gjykatësve dhe prokurorëve publikë, për dëgjuesit në pajtim me programin për mësim praktik.

(2) Gjatë mësimin praktik, secili dëgjues mund të fitojë më së shumti deri në 20 pikë.

(3) Vlerësimi ka për qëllim:

- të inkurajojë dëgjuesin të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet;

- të verifikojë aftësitë dhe shkathtësitë e arritura dhe të vlerësojë gatishmërinë e tij për kryerje të funksionin gjyqësor/prokuror publik.

(4) Mënyra e vlerësimit pas mbarimit të mësimin praktikë, në mënyrë më të përafërt rregullohet me akt të veçantë të Akademisë.

Provimi përfundimtar

Neni 54

Pas përfundimit të trajnimit praktik, dëgjuesit e trajnimit fillestar japin provimin përfundimtar me të cilën testohen njohurit dhe shkathtësitë praktike të fituara në trajnimin fillestar për kryerjen e funksionit të gjykatësit në gjykata themelore ose të një prokurori publik në prokurorinë themelore publike, përkatësisht:

- aftësia për përpilimin me shkrim të aktgjykimit, aktvendimit dhe aktakuzës,

- aftësia për udhëheqjen e procedurës si gjykatës dhe prokuror publik, dhe

- qëndrimet dhe raportet ndaj performancës profesionale dhe etike të kryerjes së funksionit të gjyqësorit, përkatësisht të prokurorit publik.

Procedura për dhënien e provimit para Komisionit përfundimtar

Neni 55

(1) Të gjithë dëgjuesit e trajnimit të cilët me sukses kanë përfunduar mësimin praktik nga trajnimi fillestar kanë të drejtë të japin provimin përfundimtar.

(2) Dëgjuesi i trajnimit humb të drejtën për të dhënë provimin përfundimtar nëse mungon në provim të cilës do pjesë të provimit përfundimtar, dhe nuk e arsyeton atë.

(3) Dëgjuesi i trajnimit mund të kërkojë nga Komisioni përfundimtar shtyrjen e dhënies së provimit përfundimtar për arsye të justifikuara.

(4) Në rastet e përmendura në paragrafin (3) të këtij neni, Komisioni përfundimtar vendos në afat prej 48 orë nga pranimi i kërkesës.

Përmbajtja e provimit përfundimtar

Neni 56

(1) Provimi përfundimtar përbëhet prej tri pjesë:

1. Pjesa me shkrim
2. Simulimi i gjykimit, dhe
3. Pjesa me gojë.

(2) Pjesa me shkrim e provimit përfundimtar përbëhet nga dy pjesë:

- përpilimi me shkrim të aktgjykimit/aktvendimit të rastit penal ose civil, dhe

- shkrimi i aktakuzës.

(3) Vlerësimi sipas paragrafit (2) të këtij neni kryhet në rastet studimore të anonimuara me një shifër.

(4) Simulimi i gjykimit realizohet sipas çështjeve civile dhe penale të parapërzgjedhura dhe të përgatitura.

(5) Pjesa me gojë e provimit përfundimtar zhvillohet në formën e një bisede të drejtpërdrejtë me kandidatin të cilit i bëhen katër pyetje, edhe atë:

- një pyetje në lidhje me aktgjykimin/aktvendimin e përgatitur nga e drejta materiale, përkatësisht
- një pyetje në lidhje me aktakuzën e përgatitur nga e drejta materiale,
- një pyetje në lidhje me rolin e realizuar në simulimin e të drejtës procedurale,
- një pyetje për vlerësimin e qëndrimeve dhe raporteve ndaj performancës profesionale dhe etike të kryerjes së funksionit të gjyqësorit, përkatësisht të prokurorit publik.

(6) Përzgjedhja e lëndëve sipas paragrafit (1) të këtij neni bëhet përmes mënyrës së tërheqjes së shortit.

(7) Gjatë dhënies së pjesë praktike (me shkrim) të provimit përfundimtar, lejohet të përdoren ligje (pa komente dhe shpjegime) të cilat në version elektronik janë në kompjuterin ku kandidati jep provimin praktik (pjesa me shkrim).

(8) Përmbajtja e provimit përfundimtar rregullohet më hollësisht me akt nënligjor të Akademisë.

(9) Numri i përgjithshëm i pikëve që dëgjuesi i trajnimit mund të marrin në provimin përfundimtar është 100 pikë, edhe atë: 35 pikë nga pjesa me shkrim, 35 pikë nga simulimi i gjyqimit dhe 30 pikë nga pjesa me gojë e provimit.

(10) Pikët përfundimtare nga Provimi përfundimtar fitohen në një mënyrë që llogaritet vlera mesatare aritmetike nga shuma totale e pikëve të marra nga secili anëtar i Komisionit Përfundimtar, shprehur në numra deri në decimalen e dytë.

(11) Në bazë të pikëve të fituara, maksimumi i të cilave është 100 pikë, fitohet nota përfundimtare, e cila është notë përmbljedhëse nga të tre pjesët e provimit, dhe nota e cila fitohet në mënyrë që numri i pikëve të fituara përpjesëtohet me 10.

(12) Konsiderohet se dëgjuesi që mori një notë shtatë ose më pak, nuk e kaloi provimin përfundimtar.

(13) Mënyra e dhënies së provimit, përmbajtja e materialit të provimit dhe mënyra e vlerësimit gjatë dhënies së provimit përfundimtar rregullohen me akt nënligjor të Akademisë.

Vlerësimi i provimit përfundimtar

Neni 57

(1) Dëgjuesi i trajnimit fillestar i cili nuk e ka kaluar provimin përfundimtar ka të drejtë të jap përsëri provimin përfundimtar në afat prej gjashtë muajve nga dita e dhënies së provimit përfundimtar.

(2) Nëse dëgjuesi i trajnimit fillestar gjatë dhënies së provimit të përsëritur përfundimtar nuk fiton të paktën shtatë pikë nga gjithsej dhjetë pikë, konsiderohet se nuk e ka përfunduar trajnimin fillestar dhe humb statusin e dëgjuesit të trajnimit fillestar.

(3) Dëgjuesi i trajnimit që mendon se gabimisht i janë llogaritur pikët e fituara në provimin përfundimtar ka të drejtë të parashtresës deri te Komisionin Përfundimtar në afat prej dy ditë pune nga dita e pranimit të njoftimit.

(4) Komisioni përfundimtar vendos ndaj parashtresës në afat prej dy ditë pune nga dita e pranimit të parashtresës në kohë.

(5) Kundër vendimit të Komisionit Përfundimtar, kandidati ka të drejtë të ankesës deri te Këshilli drejtues në afat prej tre ditë pune nga dita e pranimit të vendimit.

(6) Këshilli drejtues vendimin ndaj ankesës e sjell në afat prej dy ditë pune duke përllogaritur nga skadimi i afatit për parashttrimin e parashtresave kundër vendimit të Komisionit përfundimtar.

(7) Në seancën e Këshillit drejtues në të cilën shqyrtohen parashtresat marrin pjesë edhe kryetari i Komisionit përfundimtar ose anëtarë të cilën do e përcakton ai pa të drejtë vote.

(8) Nëse Këshilli drejtues e pranon parashtresën e kandidatit, e detyron Komisionin përfundimtar të kryejë përllogaritje të përsëritur të pikëve të fituara të lëndës e cila ka të bëjë me parashtresën.

(9) Komisioni përfundimtar pas rishikimit të parashtresës sipas paragrafit (8) të këtij neni në afat prej dy ditë pune mund ta pranojë ose refuzojë parashtresën dhe për këtë vendim bashkëngjit mendim të arsyetuar në Këshillin drejtues.

(10) Vendimi i Këshillit drejtues lidhur me parashtresën është përfundimtar.

(11) Pas hyrjes në fuqi të vendimit sipas paragrafit (10) të këtij neni, Komisioni përfundimtar publikon publikisht rang listën me rezultatet përfundimtare të kandidatëve që morën provimin në ueb faqen e Akademisë.

Lista përfundimtare e renditjes

Neni 58

(1) Pas përfundimit të trajnimit fillestar, dëgjuesi i trajnimit merr një notë përfundimtare, e cila është një shumë e notave të marra nga dy fazat e trajnimit fillestar dhe provimit përfundimtar.

(2) Komisioni përfundimtar përcakton listën përfundimtare të kandidatëve për gjykatës dhe prokurorë publikë bazuar në notën përfundimtare sipas paragrafit (1) të këtij neni.

Certifikata për trajnimin fillestar të përfunduar

Neni 59

(1) Akademia kandidatëve për gjykatës dhe prokurorë publikë ju jep vetëm certifikatë për trajnim fillestar të përfunduar për gjykatës ose prokurorë publikë, e cila përmban notën përfundimtare.

(2) Certifikata sipas paragrafit (1) të këtij neni jepet sipas një formulari të përcaktuar me një akt të Akademisë.

Të drejtat dhe detyrimet e kandidatëve për gjykatës dhe prokurorë publikë

Neni 60

(1) Pas përfundimit të trajnimit fillestar, trajnuesi në trajnimin fillestar fiton statusin e kandidatit për gjykatës dhe prokuror publik.

(2) Kandidati për gjykatës dhe prokuror publik është i detyruar të punojë në gjykatë, përkatësisht në prokurorinë publike për të paktën pesë vjet pas zgjedhjes si gjykatës ose prokuror publik, në të kundërtën është i detyruar të kompensojë shpenzimet dhe kompensimet e tjera për trajnimin e tij, pas një përllogaritje të përcaktuar nga ana e Akademisë.

(3) Kandidati për gjykatës dhe prokuror publik i cili nuk paraqitet dy herë në njoftimin për zgjedhjen e gjykatësit ose prokurorit publik, përkatësisht për gjykatës ose prokuror publik për territorin e apelit për të cilën ka aplikuar për dëgjues të trajnimit fillestar, e humb statusin e kandidatit për gjykatës dhe prokuror publik.

(4) Humbja e statusit të kandidatit për gjykatës dhe prokuror publik sipas paragrafit (3) të këtij neni do të rezultojë në kompensimin e shpenzimeve dhe kompensimin e tjera për trajnimin e tij, pas një përlogaritje të përcaktuar nga ana e Akademisë.

(5) Në rastet e paragrafëve (2) dhe (3) të këtij neni, kandidati për gjykatës dhe prokuror publik nuk është i detyruar të kompensojë shpenzimet dhe kompensimet e tjera për trajnimin e tij për shkak të një sëmundje të rëndë shëndetësore e cila dëshmohej me dokumentacion përkatës.

(6) Në rastet e përmendura në paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij neni, Këshilli Gjyqësor, përkatësisht Këshilli i Prokurorëve Publikë do të informojë dhe detyrojë shërbimet e Akademisë të bëjnë përlogaritje të kompensimit të shpenzimeve dhe kompensimet e tjera për trajnimin e tij dhe ta paguan pagesën.

V. TRAJNIMI I VAZHUESHËM I GJYKATËSVE DHE I PROKURORËVE PUBLIKË

Trajnim i vazhdueshëm

Neni 61

(1) Trajnimi i vazhdueshëm paraqet përmirësim i vazhdueshëm profesional i njohurive dhe aftësive teorike dhe praktike për kryerjen profesionale dhe efikase të funksionit gjyqësor dhe të prokurorisë publike, të shërbimeve profesionale në gjyqësor dhe prokurori publike, si dhe subjekteve të tjera nga neni 2 të këtij ligji.

(2) Trajnimi i vazhdueshëm mund të jetë i detyrueshëm ose vullnetar.

(3) Kohëzgjatja e trajnimit të vazhdueshëm të detyrueshëm të gjykatësve dhe prokurorëve publikë përcaktohet më hollësisht me aktet nënligjore të Akademisë në varësi të stazhit të punës.

(4) Këshilli i programit i Akademisë miraton program për trajnim të vazhdueshëm.

(5) Trajnimi i vazhdueshëm kryhet gjithashtu edhe për gjykatësit e jurisë.

(6) Trajnimi i vazhdueshëm kryhet edhe për shërbimet profesionale në gjyqësor dhe prokurori publike, si dhe subjektet që marrin pjesë në zbatimin e ligjeve në fushën e gjyqësisë.

(7) Mënyra e vlerësimit të nevojave për trajnim të vazhdueshëm të subjekteve të përmendura në nenin 2 të këtij ligji, si dhe mënyra e zbatimit dhe vlerësimit të tij rregullohen me akt të Akademisë.

(8) Akademia organizon trajnime të vazhdueshme në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me bashkëpunëtorët vendas dhe të huaj.

(9) Dëgjuesit e trajnimit të vazhdueshëm në një vendbanim tjetër nga vendi i trajnimit, kanë të drejtën e kompensimit të shpenzimeve rrugore reale të bëra, të përcaktuara me një akt të Akademisë.

Program i përgjithshëm për trajnim të vazhdueshëm

Neni 62

Përmbajtja, kohëzgjatja dhe mënyra e kryerjes së trajnimit të vazhdueshëm përshkruhet me programin e përgjithshëm për trajnim të vazhdueshëm dhe aktet e Akademisë.

Program i specializuar për trajnim të vazhdueshëm të detyrueshëm

Neni 63

(1) Gjykatësit e sapozgjedhur dhe prokurorët publikë janë të detyruar të ndjekin trajnimin e vazhdueshëm menjëherë pas zgjedhjeve për gjykatës ose prokuror publik.

(2) Përmbajtja, kohëzgjatja dhe zbatimi i trajnimit të vazhdueshëm sipas paragrafit (1) të këtij neni përcaktohet në programin e specializuar për trajnim të vazhdueshëm të detyrueshëm.

Program i specializuar për trajnim të vazhdueshëm vullnetar

Neni 64

(1) Përmbajtja, kohëzgjatja dhe zbatimi i trajnimit të vazhdueshëm vullnetar përcaktohet në programin e specializuar për trajnim të vazhdueshëm vullnetar.

(2) Akademia informon gjykatat, prokuroritë publike dhe subjektet e përmendura në nenin 2 të këtij ligji për programin e përmendur në paragrafin (1) të këtij neni.

VI. SHËRBIMI I PUNËVE TEKNIKO-PROFESIONALE I AKADEMISË

Neni 65

(1) Të punësuarit në Akademi kanë statusin e nëpunësit publik administrativ dhe në lidhje me të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre zbatohen Ligji i Nëpunësve Administrativë, Ligji i të Punësuarve në Sektorin Publik, rregulloret e përgjithshme të marrëdhënies së punës dhe këtë Ligj.

(2) Të punësuarit në Akademinë e Gjykatësve dhe të Prokurorëve Publikë kanë të drejtë për një kompensim të veçantë të pagës në varësi të specifikave të detyrave të punës, mënyrës dhe kushteve për kryerjen e tyre, disponueshmërisë së vazhdueshme, kualifikimeve profesionale të fituara, konfidencialitetit dhe vëllimi i rritur i punëve.

(3) Kompensimi i paragrafit (2) të këtij neni nuk mund të jetë më e lartë se 35% e shumës së pagës bazë dhe i njëjti paguhet për një periudhë të caktuar kohore.

(4) Kriteret për pagimin e kompensimit sipas paragrafit (2) të këtij neni me akt në mënyrë më të përafërt i përcakton drejtori.

(5) Të punësuarit që kryejnë punë ndihmëse ose teknike nuk kanë statusin e nëpunësit administrativ dhe në lidhje me të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre, zbatohet neni 3 i Ligjit të të Punësuarve në Sektorin Publik.

VII. FINANCIMI DHE MJETET E PUNËS SË AKADEMISË

Burimet e financimit

Neni 66

(1) Mjetet për punën e Akademisë sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut nëpërmjet buxhetit të "Pushtetit gjyqësor".

(2) Burime të tjera të financimit janë:

- të ardhura të pavarura

- të ardhurat përmes botimit,

- të ardhurat nga realizimi i trajnimeve për gjyqësorin dhe për grupet e tjera të synuara që janë jashtë fushës së gjyqësorit,

- realizimi i projekteve,

- grante dhe donacione, të cilat nuk bien ndesh me veprimtarinë e Akademisë.

(3) Drejtori i Akademisë informon Këshillin drejtues për burimet e përmendura në paragrafin (2) të këtij neni.

(4) Mjetet buxhetore sipas paragrafit (1) të këtij neni sigurohen në lartësi për të mbuluar organizimin dhe zbatimin e provimeve, programeve të trajnimit, si dhe shpenzimet e tjera që dalin nga funksionimi rrjedhës i Akademisë në pajtim me këtë ligj.

Mbikëqyrja

Neni 67

Mbikëqyrja mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji kryhen Ministria e Drejtësisë.

VIII. DISPOZITAT E KUNDËRVAJTJES

Neni 68

Gjobë në shumë prej 10,000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për një kundërvajtje ndaj një personi juridik të autorizuar që teknikisht zhvillon provimin, nëse nuk bllokoi rjetin e frekuencës së radios në hapësirën e dhënies së provimit (neni 41 paragrafi (1) të këtij ligji).

Neni 69

Gjobë në shumë prej 1000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet një anëtar i Komisionit të revizionit për një kundërvajtje nëse konstaton parregullsi në realizimin e provimeve, ndërsa të cilat nuk e ka konstatuar në raportin e dorëzuar deri te Këshilli drejtues i Akademisë.

Neni 70

Për kundërvajtjet e përcaktuara me këtë ligj procedurën e kundërvajtjes dhe sanksionin e kundërvajtjes e shqipton gjykata kompetente.

IX. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 71

(1) Drejtori, zëvendës-drejtori, anëtarët e Këshillit drejtues dhe të Këshillit të programit të Akademisë të emëruar në pajtim me Ligjin e Akademisë së Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 20 / 15, 192/15; 231/15 dhe 163/18), do të kryejnë detyrën deri në mbarim të mandatit për të cilin janë zgjedhur.

(2) Komisioni i provimit pranues, Komisioni i provimit përfundimtar dhe Komisioni i revizionit të provimeve të mbajtura do të kryejnë detyrën deri në mbarimin e mandatit për të cilin janë zgjedhur.

(3) Drejtori, zëvendës-drejtori dhe anëtarët e organeve sipas paragrafit (1) të këtij neni të cilët zgjidhen për herë të parë në pajtim me Ligjin e Akademisë së Gjykatësve dhe të Prokurorëve Publikë ("Gazeta Zyrtare e Republika e Maqedonisë" numër 20/15, 192/15, 231/15 dhe 163/18) kanë të drejtë të zgjidhen edhe njëherë sipas këtij ligji.

(4) Drejtori, anëtarët e Këshillit drejtues, Këshilli të programit dhe komisionet e provimit pranues, të revizionit të provimeve të mbajtura dhe të provimit përfundimtar të Akademisë të emëruar në dy mandate deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji në pajtim me rregulloret që ishin të vlefshme deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk kanë të drejtë për një mandat tjetër sipas këtij ligji.

Neni 72

(1) Të gjitha procedurat e filluara për pranimin e dëgjuesve në trajnimin fillestar në Akademinë e Gjykatësve dhe të Prokurorëve Publikë do të zbatohen dhe do të përfundojnë në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(2) Gjenerata e kandidatëve për gjykatës dhe prokurorë publikë e cila në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji është duke vijuar trajnimin, të njëjtin do ta përfundojnë në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 73

Aktet nënligjore të parashikuara me këtë ligj do të miratohen nga Këshilli drejtues në afat prej një muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 74

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji ndërpritet të vlejë Ligji i Akademisë së Gjykatësve dhe të Prokurorëve Publikë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 20/15, 192 / 15, 231/15 dhe 163/18).

Neni 75

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“.

2393.

Врз основа на членот 75, ставови 1 и 2 од Уставот на Република Северна Македонија, претседателот на Република Северна Македонија и претседателот на Собранието на Република Северна Македонија, издаваат

УКАЗ

ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА МАТИЧНАТА ЕВИДЕНЦИЈА

Се прогласува Законот за изменување и дополнување на Законот за матичната евиденција,

што Собранието на Република Северна Македонија го донесе на седницата одржана на 14 јуни 2023 година.

Бр. 08-3271/1
14 јуни 2023 година
Скопје

Претседател на Република
Северна Македонија,
Стево Пендаровски, с.р.

Претседател
на Собранието на Република
Северна Македонија,
м-р **Talat Xhaferi**, с.р.

ЗАКОН

ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА МАТИЧНАТА ЕВИДЕНЦИЈА

Член 1

Во Законот за матичната евиденција („Службен весник на Република Македонија“ број 8/95, 38/2002, 66/2007, 98/2008, 67/2009, 13/13, 43/14, 148/15, 27/16 и 64/18 и „Службен весник на Република Северна Македонија“ број 14/20), по членот 4 се додава нов член 4-а, кој гласи: